

VENDIM
Nr. 168, datë 19.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 20, DATË 17.1.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘LIDHJA E RRUGËS
TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORË’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 20, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Lidhja e Rrugës Transballkanike me Portin Detar Vlorë’”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 3 dhe 4, fjalët “... prej 200 831 026.08 (dyqind milionë e tetëqind e tridhjetë e një mijë e njëzet e gjashtë pikë zero tetë) lekësh ...” zëvendësohen me “... 204 401 080.58 (dyqind e katër milionë e katërqind e një mijë e tetëdhjetë pikë pesëdhjetë e tetë) lekë ...”;

b) Në tabelën bashkëlidhur vendimit shtohen pasuritë me numrat rendorë 56-57, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Vlorë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME PORTIN DETAR VLORË”

NR	Pronari			ZK	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m²	Ndërtesë m²	Adresa	Sipërfaqe truallit për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
56	Arben	Ramadan	Mamanaj	8604	32/134+1-13	Apartament	74	39		18	Vlore			-	18	52,296.00	941,328.00	941,328.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Pasuria e llojit apartament. Kartela është e vlefshme vetëm për shpronësim.
	Emiljana	Ramadan	Xhaferaj																
	Marinela	Ramadan	Mamanaj																
	Gentjan	Ramadan	Mamanaj																
57	Fatmir	Remzi	Idrizi	8604	32/33+1-7	Apartament	74	48	47.5	44	Vlore	47.50	6,899.00	327,702.50	44	52,296.00	2,301,024.00	2,628,726.50	Konfirmuar nga ASHK-ja. Te seksioni E - për këtë apartament është privatizuar edhe sipërfaqja e truallit prej 47.5 m². Lëshohet për efekt shpronësimi.
	Vjollca	Brahim	Idrizi																
	Lumturi		Dine																
	Sheme	Remzi	Berati																
	Dylbere	Remzi	Sako																
	Suzana	Remzi	Idrizi																
	Feta	Remzi	Idrizi																
	Armida	Sezai	Sinani																
	Luçjana	Sezai	Rubino																
	Gentjan	Sezai	Sinani																
	Shpendi	Sezai	Sinani																
	Lira	Remzi	Idrizi																
	Astrit	Ali	Avdulla																
	Vlera totale shtesë e shpronësimit																	3,570,054.50	